



**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

**STANDARDI I PROFESIONIT**

**Asistent i punëtorit të prodhimit – përpunimi i frutave, perimeve dhe mishit (Arsimi për fëmijë me nevoja të veçanta)**

**Spektori: Përpunimi i ushqimit**

**Kodi: 932**

**Data e miratimit:**

Ky standard i profesionit është zhvilluar nga projekti ALLED "Harmonizimi i Arsimit me Kërkesa të Tregut të Punës"



**Ekipi i zhvillimit:**

**Udhëheqësi i ekipit:**

**Sanja Crnkovic Pozaic – eksperte**

**Josip Juracak, PhD, ekspert në fushën e bujqësisë**

**Përbërja e ekipit:**

**Mërgim Mestani, SHMLP “Abdyl Frashëri” Prishtinë**

**Almir Abdurramani, SHMLP “Abdyl Frashëri” Prishtinë**

**Mërgim Mestani, SHMLP “Abdyl Frashëri” Prishtinë**

**Almir Abdurramani, SHMLP “Abdyl Frashëri” Prishtinë**

**Hajriz Neziri, SHMLP “Abdyl Frashëri” Prishtinë**

**Afërdita Lajqi, SHMLP “Ali Hadri” Pejë**

**Shahin Ahmetxhekaj, SHMLP “Ali Hadri” Pejë**

**Fahrije Vucetaj, SHMLP “Ali Hadri” Pejë**

**Vjosa Hana, SHMLP “Kadri Kusari” Gjakovë**

**Halil Berisha, SHMLP “Ali Hadri” Pejë**

**Data e miratimit**

**Valid:** për periudhë 5 vjeçare

**Kodi i profesionit: 932**

**Profesioni: Asistent i punëtorit të prodhimit – përpunimi i frutave, perimeve dhe mishit (Arsimi për fëmijë me nevoja të veçanta)**

**Përshkrim i profesionit**

Punëtorët e prodhimit kryejnë punë/detyra të ndryshme të thjeshta dhe rutinore në përpunimin e ushqimit (fruta dhe perime) nën mbikëqyrje të tjerëve. Ata asistojnë në punën e teknikëve dhe operatorëve e montuesve të makinave në prodhimin e produkteve ushqimore. Këto detyra zakonisht përfshijnë: paketimin e materialeve dhe produkteve të ndryshme me dorë; mbushjen me dorë të shisheve, kutive, qeseve dhe ambalazhave tjera me produkte; vendosjen e etiketave në produkte dhe në ambalazha me dorë; ngarkimin dhe shkarkimin e mjeteve të transportit; bartjen e mallrave, materialeve dhe pajisjeve tek hapësirat punuese; pastrimin e makinerisë, pajisjeve dhe veglave; klasifikimi i produkteve ose komponentëve me dorë. Profesionet në këtë grup klasifikohen në grupet e njësisive si vijon: 9321 ambalazhues me dorë 9329 punëtorë prodhimi të pa specifikuar.

Karakteristikë specifike e këtij profesioni sa i përket këtij përshkrimi nga ISCO klasifikimet 08 është se vendi i punës në këto profesione është i mbushur me nevoja të veçanta mësimore prandaj duhet bërë disa ndryshime në standardin e profesionit për të përmbushur nevojat e tyre.

Për këtë arsye është vendosur fjala “Asistent” para emrit të profesionit nga klasifikimi për të treguar se personat me nevoja të veçanta mësimore zakonisht kanë nevojë për dikë që t’i udhëzojë dhe asistojë gjatë procesit të punës.

**Profesioni: Asistent i punëtorit të prodhimit – përpunimi i frutave dhe perimeve (Arsimi me nevoja të veçanta)**

Asistent punëtoret e prodhimit – për përpunimin e frutave dhe perimeve kryejnë punë/detyra të ndryshme të thjeshta dhe rutinore në përpunimin e frutave dhe perimeve për të ndihmuar në punën e teknologut dhe teknikëve.

Detyrat zakonisht përfshijnë: përgatitjen e lëndëve të para për përpunim; mbushjen e linjave të përpunimit; mbushjen e shisheve, kutive dhe ambalazhave tjera me produkt final me dore duke përdorë makinat përkatëse; etiketimin e produkteve të paketuara; ngarkimin, shkarkimin dhe bartjen e furnizimeve dhe produkteve finale brenda repartit të prodhimit; pastrimin e makinerive, pajisjeve dhe mjeteve; largimin e mbeturinave.

Kohëzgjatja e punës varet nga kërkesat e procesit të prodhimit. Shpeshherë varet edhe nga sezona. Kushtet e punës në shumë aktivitete kërkojnë përdorimin e masave dhe mjeteve për siguri në punë si dhe përdorimin e rrobave dhe pajisjeve mbrojtëse. Klima në hapësirën e prodhimit mund të jetë e pafavorshme me temperatura të larta dhe me nivel të lartë të lagështisë. Për këtë arsye, preferohet një nivel i caktuar i tolerancës ndaj kushteve të papërshtatshme. Për disa prej aktivitete nevojitet fuqi fizike dhe qëndrueshmëri.

**Profesioni: Asistent punëtor prodhimi – përpunimi i frutave dhe perimeve (Arsimi me nevoja të veçanta)**

Nr.	Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1	Përgatit vendin e punës	Ky funksion përfshin marrjen e instruksioneve për punë ditore nga mbikëqyrësi ose planin ditor në formë të shkruar. Po ashtu ka të bëjë me përgatitjen e mjeteve të zakonshme të punës, përgatitjen e materialit kryesor dhe ndihmës për prodhim dhe paketim, si dhe me ndërmarrjen e masave të nevojshme për siguri në punë.
2	Përgatit lëndën e parë për përpunim	Ky funksion ka të bëjë me aktivitetet për përgatitjen e frutave, perimeve ose mishit për përpunim. Kjo përfshinë transportimin, largimin nga paketimi, matjen, pastrimin, larjen, kontrollimin vizual, largimin e pjesëve jo adekuate, prerjen, qërimin, ngjeshjen dhe vendosjen në linjën e përpunimit.
3	Paketon dhe deponon produktet	Ky funksion ka të bëjë me aktivitete për pranimin dhe paketimin e produkteve të përfunduara, me dorë ose në një linjë të vogël paketimi. Kjo përfshinë kontrollimin e produktit final, vendosjen e produktit në kontejnerin për paketim, etiketimin, dhe transportimin e produkteve të paketuara në depo. Nëse procesi i paketimit është i mekanizuar, atëherë përfshihen aktivitete si mbushja e makinës, monitorimi i procesit, dhe largimi i produkteve të përfunduara.
4	Zbaton rregulloret dhe mbron ambientin në vendin e punës	Ky funksion ka të bëjë me aplikimin e higjienës personale, rregullave për siguri të ushqimit, dhe aplikimin e praktikave për mbrojtje të ambientit gatë largimit të mbeturinave.

## Funksioni 1: Përgatit vendin e punës

Ky funksion përfshin marrjen e instruksioneve për punë ditore nga mbikëqyrësi ose planin ditor në formë të shkruar. Po ashtu ka të bëjë me përgatitjen e mjeteve të zakonshme të punës, përgatitjen e materialit kryesor dhe ndihmës për prodhim dhe paketim, si dhe me ndërmarrjen e masave të nevojshme për siguri në punë.

Aktivitetet kryesore	Kriteret e performances	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksione kyçe
Merr instruksionet për punë	Merr instruksionet nga mbikëqyrësi dhe i zbaton ato në mënyrën e duhur. Lexon instruksione të thjeshta të punës ditore dhe i zbaton ato.	Leximi i udhëzimeve të thjeshta për punë;	Leximi dhe zbatimi i udhëzimeve të thjeshta në gjuhë amtare;	Komunikim ndërpersonal në gjuhën amtare (në të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar); Aftësi për të punuar në kushte të papërshtatshme; I/e hapur ndaj këshillave; Vëmendje ndaj detajeve; Fuqi dhe qëndrueshmëri fizike për disa prej aktiviteteve; Reagim i shpejtë në rast të problemeve;
Zgjedh mjetet për punë dhe përgatitë linjën e prodhimit	Zgjedh mjetet e duhura të punës. Kontrollon linjën e prodhimit për defekte të dukshme. Aktivizon linjën e prodhimit nën mbikëqyrje.	Praktika të mira higjienike; Procedura të zakonshme të pastrimit;	Komunikimi me mbikëqyrësin;	
Përgatit materialet e prodhimit	Merr materialin e nevojshëm Kontrollon materialin e prodhimit sa i përket llojit, cilësisë dhe sasisë në përputhje me instruksionet.	Pajisje dhe mjete të zakonshme për punë; Lloje e lëndëve të para dhe furnizimeve tjera;	Aritmetikë e thjeshtë (numërimi, mbledhja, zbritja); Matja e peshës;	
Ndërmerr masa për higjienë dhe siguri në punë nën mbikëqyrje	Mirëmban nivelin e kërkuar të higjienës personale. Mban vendin e punës të pastër dhe në rregull. Vesh rrobat personale mbrojtëse sipas instruksioneve. Zbaton masat për siguri në punë në	Operimi i pajisjeve nën mbikëqyrje; Masat dhe metodat obligative për siguri në punë;	Dallimi i vetive organoleptike; Përdorimi i sigurt i mjeteve dhe pajisjeve nën mbikëqyrje; Përdorimi i mjeteve që manipulohen me dorë në mënyrën e duhur; Mbajtja e higjienës personale në nivel;	

	përputhje me instruksionet e dhëna.			
--	-------------------------------------	--	--	--

**Kushtet e nevojshme për kryerjen e funksionit:**

Përgatitja për punë i referohet përgatitjes së kushteve optimale për punë si dhe parandalimin e problemeve në procesin e prodhimit. Për të qen në gjendje të ushtrjnë këtë funksion kandidatët duhet të kenë në dispozicion dhe të jenë në gjendje të përdorin: linja prodhimi eksperimentale dhe komerciale (punëtori) për praktikim, mjete dhe pajisje për higjienë personale, rroba mbrojtëse, dhe lloje të ndryshme të frutave dhe perimeve për përpunim.

**Kërkesat për vlerësim:**

Vlerësimi duhet të bazohet në provim me gojë dhe praktikë. Provimi me gojë duhet të shoqërohet edhe me materiale për testim me shkrim në mënyrë që kandidati të und të demonstrojë të kuptuarit e koncepteve themelore të mësuara.

Pos kësaj, kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në punëtori për të demonstruar njohuritë dhe shkathtësitë praktike.



## Funksioni 2: Përgatit lëndën e parë për përpunim

Ky funksion ka të bëjë me aktivitetet për përgatitjen e frutave, perimeve dhe mishit për përpunim. Kjo përfshinë transportimin, largimin nga paketimi, matjen, pastrimin, larjen, kontrollimin vizual të frutave, perimeve ose mishit për përpunim. Po ashtu përfshinë, largimin e pjesëve jo adekuate, dhe vendosjen e lëndës së parë në linjën e përpunimit.

Aktivitetet kryesore	Kriteret e performances	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksione kyçe
Kontrollon frutat, perimet ose mishin për përpunim	<p>Transporton dhe shkarkon lëndën e parë në mënyrën e duhur.</p> <p>Kontrollon vizualisht lëndën e parë dhe largon përmbajtjet e padëshiruara.</p> <p>Kontrollon frutat dhe perimet dhe kontrollon pjesët e dëmtuara.</p>	<p>Llojet e frutave, perimeve ose mishit dhe pjesët e tyre shfrytëzueshme dhe ato që hahen;</p> <p>Mangësitë në fruta, perime ose në mish që ndikojnë në rezultatin e përpunimit;</p>	<p>Leximi dhe zbatimi i udhëzimeve të thjeshta në gjuhë amtare;</p> <p>Komunikimi me mbikëqyrësin;</p> <p>Aritmetikë e thjeshtë (numërimi, mbledhja, zbritja);</p> <p>Përdorimi i sigurt i mjeteve dhe pajisjeve nën mbikëqyrje;</p>	<p>Komunikim ndërpersonal në gjuhën amtare (në të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar);</p> <p>Aftësi për të punuar në kushte të papërshtatshme;</p> <p>Vëmendje ndaj detajeve;</p> <p>Fuqi dhe qëndrueshmëri fizike për disa prej aktiviteteve;</p>
Pastron dhe përgatitë frutat, perimet ose mishin për përpunim	<p>Pastron dhe lan frutat dhe perimet për përpunim.</p> <p>Prenë, qëron lëndët e para dhe vendos ato në linjën e përpunuese.</p> <p>Raporton defektet dhe problemet tek mbikëqyrësi.</p>	<p>Mënyrat e prerjes, qërimin dhe teknika tjera për përgatitjen e lëndës së parë.</p> <p>Praktika të mira higjienike dhe të pastrimit;</p> <p>Tiparet dhe kërkesat e linjave të prodhimit;</p>	<p>Përdorimi i mjeteve që manipulohen me dorë në mënyrën e duhur;</p> <p>Mbajtja e higjienës personale në nivel;</p> <p>Llogaritja e peshës;</p> <p>Veshja e uniformes dhe veshjeve mbrojtëse kur është e nevojshme;</p>	<p>Vëmendje ndaj punës në progres;</p> <p>Reagim i shpejtë në rast të problemeve;</p> <p>Shkathtësi manuale;</p>

**Kushtet e nevojshme për kryerjen e funksionit:**

Për të qen në gjendje të ushtrojnë këtë funksion kandidatët duhet të kenë në dispozicion dhe të jenë në gjendje të përdorin: uniformen, pakon higjienike, udhëzimet për punë, materialet e prodhimit, mjetet dhe/ose pajisjet, dhe manualin e pajisjeve. Aktivitetet që përfshijnë punë me pajisje duhet të kryhen nën mbikëqyrje.

**Kërkesat për vlerësim:**

Vlerësimi duhet të bazohet në provim me gojë dhe praktikë. Provimi me gojë duhet të shoqërohet edhe me materiale për testim me shkrim në mënyrë që kandidati të und të demonstrojë të kuptuarit e koncepteve themelore të mësuara.

Pos kësaj, kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në punëtori për të demonstruar njohuritë dhe shkathtësitë praktike.

### Funksioni 3: Paketon dhe deponon produktet

Ky funksion ka të bëjë me aktivitete për pranimin dhe paketimin e produkteve të përfunduara, me dorë ose në një linjë të vogël paketimi. Kjo përfshinë kontrollimin e produktit final, vendosjen e produktit në kontejnerin për paketim, etiketimin, dhe transportimin e produkteve të paketuara në depo. Nëse procesi i paketimit është i mekanizuar, atëherë përfshihen aktivitete si mbushja e makinës, monitorimi i procesit, dhe largimi i produkteve të përfunduara.

Aktivitetet kryesore	Kriteret e performances	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksione kyçe
Paketon produktin final me dorë	<p>Përgatit materialin e duhur për paketim dhe etiketim.</p> <p>Mat sasinë e produktit final në mënyrën e duhur.</p> <p>Mbush shishet, kavanozat, kutitë, qeset dhe ambalazha tjera me produktin final që plotëson standardin.</p> <p>Mbyll ambalazhat në mënyrën e duhur.</p> <p>Etiketon produktet në mënyrën e duhur me dorë.</p>	<p>Standardet e produktit final;</p> <p>Matja e sasisë (pesha, numri, volumi);</p> <p>Aritmetika e thjeshtë;</p> <p>Llojet e ambalazhave;</p> <p>Kërkesat për etiketim;</p> <p>Praktika të mira higjienike dhe të pastrimit;</p>	<p>Leximi dhe zbatimi i udhëzimeve të thjeshta në gjuhë amtare;</p> <p>Komunikimi me mbikëqyrësin;</p> <p>Aritmetikë e thjeshtë (numërimi, mbledhja, zbritja);</p> <p>Përdorimi i sigurt i mjeteve dhe pajisjeve nën mbikëqyrje;</p>	<p>Komunikim ndërpersonal në gjuhën amtare (në të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar);</p> <p>Aftësi për të punuar në kushte të papërshtatshme;</p> <p>Vëmendje ndaj detajeve;</p> <p>Fuqi dhe qëndrueshmëri fizike për disa prej aktiviteteve;</p>
Paketon produktin final duke përdorë makinën	<p>Përgatit materialin e duhur për paketim dhe etiketim.</p> <p>Mbush makinën me produktin final që plotëson standardin.</p> <p>Mbush makinën me pakot për ambalazhim dhe me etiketa.</p> <p>Kryen punë tjera me dorë në përputhje me kërkesat e linjës së ambalazhimit.</p> <p>Monitoron procesin e ambalazhimit.</p>	<p>Mjete të zakonshme të transportit që manipulohen me dorë;</p> <p>Tiparet dhe kërkesat e linjave të paketimit;</p> <p>Problemet më të zakonshme të linjave të paketimit;</p>	<p>Përdorimi i mjeteve që manipulohen me dorë në mënyrën e duhur;</p> <p>Mbajtja e higjienës personale në nivel;</p> <p>Llogaritja e peshës;</p> <p>Veshja e uniformes dhe veshjeve</p>	<p>Vëmendje ndaj punës në progres;</p> <p>Reagim i shpejtë në rast të problemeve;</p> <p>Shkathtësi manuale;</p>

	Raporton defektet dhe problemet tek mbikëqyrësi.		mbrojtëse kur është e nevojshme;	
Bart dhe deponon produktin final	Përgatit produktet e paketuara për transportim. Ngarkon dhe shkarkon makinat transportuese. Bart produktet finale në depo.			

**Kushtet e nevojshme për kryerjen e funksionit:**

Për të qen në gjendje të ushtrorjnë këtë funksion kandidatët duhet të kenë në dispozicion dhe të jenë në gjendje të përdorin: uniformen, pakon higjienike, udhëzimet për punë, materialet e prodhimit, mjetet dhe/ose pajisjet, dhe manualin e pajisjeve. Aktivitetet që përfshijnë punë me pajisje duhet të kryhen nën mbikëqyrje.

**Kërkesat për vlerësim:**

Vlerësimi duhet të bazohet në provim me gojë dhe praktikë. Provimi me gojë duhet të shoqërohet edhe me materiale për testim me shkrim në mënyrë që kandidati të und të demonstrojë të kuptuarit e koncepteve themelore të mësuara.

Pos kësaj, kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në punëtori për të demonstruar njohuritë dhe shkathtësitë praktike.

#### Funksioni 4: Zbaton rregulloret dhe mbron ambientin në vendin e punës

Ky funksion ka të bëjë me aplikimin e higjienës personale, rregullave për siguri të ushqimit, dhe aplikimin e praktikave për mbrojtje të ambientit gatë largimit të mbeturinave.

Aktivitetet kryesore	Kriteret e performances	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksione kyçe
Zbaton rregulloren për higjienë personale dhe siguri në punë sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrje	<p>Mirëmban nivelin e kërkuar të higjienës personale.</p> <p>Zbaton masat për siguri në punë në mënyrën e duhur dhe rregullisht.</p> <p>Identifikon vërejtjet dhe alarmet vizuale, verbale dhe audio në mënyrë korrekte.</p> <p>Përdor materiale që përbëjnë rrezik potencial duke treguar kujdes të duhur.</p>	<p>Rreziqet potenciale q ëi shoqërojnë aktivitetet, materialet dhe mjetet e zakonshme të punës;</p> <p>Masat parandaluese përfshirë përdorimin e pajisjeve për mbrojtje personale;</p> <p>Vërejtjet dhe alarmet bazike vizuale, audio dhe verbale;</p>	<p>Mbajtja e higjienës personale në nivel;</p> <p>Veshja e uniformes dhe veshjeve mbrojtëse kur është e nevojshme;</p> <p>Leximi dhe zbatimi i udhëzimeve të thjeshta në gjuhë amtare;</p> <p>Komunikimi me mbikëqyrësin;</p> <p>Aritmetikë e thjeshtë (numërimi, mbledhja, zbritja);</p>	<p>Komunikim ndërpersonal;</p> <p>Vëmendje ndaj punës në progres;</p> <p>Reagim i shpejtë në rast të problemeve;</p> <p>Tolerancë ndaj kushteve të papërshtatshme klimatike</p> <p>Aftësi për të punuar në kushte të papërshtatshme;</p> <p>I/e hapur për këshilla;</p>
Zbaton rregulloret për siguri të ushqimit sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrje.	<p>Kryen pastrimin, larjen dhe dezinfektimin e vendit të punës sipas udhëzimeve.</p> <p>Kryen pastrimin, larjen dhe dezinfektimin e pajisjeve sipas udhëzimeve.</p> <p>Mban vendin e punës në rendin e duhur.</p>	<p>Rëndësia e mbajtjes së vendit të punës pastër;</p> <p>Procedurat në rast të emergjencës;</p> <p>Mënyrat e duhura për mirëmbajtjen dhe hedhjen e nënprodukteve dhe mbeturinave;</p>	<p>Përdorimi i sigurt i mjeteve, pajisjeve dhe materialeve që manipulohen me dorë;</p> <p>Përdorimi bazik i ndihmës së parë;</p> <p>Dallimi i defekteve në procesin e prodhimit;</p>	<p>Fuqi dhe qëndrueshmëri fizike për disa prej aktiviteteteve;</p> <p>Tolerancë ndaj orarit fleksibil të punës;</p>
Aplikon praktika të hedhjes së mbeturinave	Largon mbetjet dhe tepricat nga vendi i punës në mënyrën e duhur.		Njohja e llojeve të ndryshme të	

që marrin parasysh mbrojtjen e ambientit	Menaxhon mbeturinat në një mënyrë që nuk është e dëmshme për ambientin.		mbeturinave dhe kontejnerëve përkatës;	
--	---	--	--	--

**Kushtet e nevojshme për kryerjen e funksionit:**

Për të qen në gjendje të ushtrojnë këtë funksion kandidatët duhet të kenë në dispozicion dhe të jenë në gjendje të përdorin: uniformen, pakon higjienike, shenja të ndryshme paralajmëruese, udhëzime në rast emergjence, punëtori e pajisur ose hapësirë për reklamim të produkteve, mjete për largimin e mbeturinave dhe kontejner të ndryshëm.

**Kërkesat për vlerësim:**

Vlerësimi duhet të bazohet në provim me gojë dhe praktikë. Provimi me gojë duhet të shoqërohet edhe me materiale për testim me shkrim në mënyrë që kandidati të und të demonstrojë të kuptuarit e koncepteve themelore të mësuara.

Pos kësaj, kandidati i nënshtrohet provimeve praktike në punëtori për të demonstruar njohuritë dhe shkathtësitë praktike.